



REPUBLIKA E SHQIPËRISE

DEPARTAMENTI I ADMINISTRATËS PUBLIKE

1404 2016

Nr. Prot. 1487

**Drejtuar:** Z. Petrit MALAJ  
Rektor i Universitetit të Arteve, Tiranë

**Lënda:** Mbi zbatimin e ligjit nr. 138/2015 dhe të vendimit nr. 17/2016, të Kuvendit të Shqipërisë

I nderuar zoti Malaj,

Në bazë të ligjit nr. 138/2015, "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike" dhe të vendimit nr. 17/2016, të Kuvendit të Shqipërisë, "Për përcaktimin e rregullave të detajuara mbi zbatimin e ndalimeve të parashikuara në ligjin nr. 138/2015, "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike", Departamenti i Administratës Publike është përgjegjës për marrjen në dorëzim, administrimin dhe përpunimin e formularëve të vetëdeklarimit për nëpunësit në shërbimin civil dhe shërbimin diplomatik, si dhe drejtuesit e çdo niveli në administratën publike të nivelit qendror dhe vendor që nuk përfshihet në shërbimin civil, (shkronja "gj", e pikës 4, të kreut II, të vendimit nr.17/2016 të Kuvendit të Shqipërisë).

Sipas përcaktimit të pikës 1, të kret VI, të vendimit nr. 17/2016, të Kuvendit të Shqipërisë, nëpunësit/funksionarët publikë si më sipër duhet të dorëzojnë pranë Departamentit të Administratës Publike formularët e vetëdeklarimit deri në datën 5 maj 2016.

Më pas, Departamenti i Administratës Publike, sipas përcaktimit të pikës 3, të kreut VI, të vendimit nr. 17/2016, të Kuvendit të Shqipërisë, brenda datës 10 maj 2016, duhet të evidentojë nëpunësit/funksionarët publikë të cilët nuk kanë depozituar formularët e vetëdeklarimit.

Për sa më sipër, si dhe me qëllimin e respektimit të të gjitha detyrimeve ligjore dhe zbatimit me rigorozitet të këtij legjislacioni, Departamenti i Administratës Publike kërkon nga ana juaj që brenda datës 20 prill 2016, të na vini në dispozicion:

- Listën e drejtuesve të çdo niveli në rektoratin e universitetit, si dhe në institucionet e arsimit të lartë në përbërje të universitetit që ju drejtoni.

Listat si më sipër, duhet të plotësohen në mënyrë elektronike në formatin që e gjeni në linkun përkatës si më poshtë:

- Për drejtues të çdo niveli, jo nëpunës civilë!

<http://goo.gl/forms/afz6lvhrhz>

Do të dëshironim të sillnim në vëmendjen tuaj që në listat si më sipër **nuk duhet të përfshihen** nëpunësit/funksionarët e përcaktuar në shkronjat "ç", "dh" dhe "ë" të pikës 4, të kreut II, të vendimit nr. 17/2016, të Kuvendit të Shqipërisë.

Gjithashtu, do të kërkonim bashkëpunimin tuaj për të njoftuar të gjithë nëpunësit/funksionarët publikë të përcaktuar në shkronjën "gj", të pikës 4, të kreut II, të vendimit nr. 17/2016, të Kuvendit të Shqipërisë për detyrimin që kanë për dorëzimin pranë Departamentit të Administratës Publike të formularit të vetëdeklarimit **brenda datës 5 maj 2016**. Ndërkohë, ju bëjmë me dije se nga ana e Departamentit të Administratës Publike janë marrë masat e nevojshme për vënien në dispozicion të bazës ligjore dhe të formularit të vetëdeklarimit në faqen zyrtare të DAP ([www.dap.gov.al](http://www.dap.gov.al)).

Duke Ju falenderuar për bashkëpunimin.

Me respekt,

**Albana Koçiu**  
Drejtor Departamentit

